



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 06 .

Prishtinë, më 20.12.2017 në ora 9:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: kryetari i komisionit- Igor Simić, anëtarët tjerë: Kujtim Shala, Fadil Beka, Zoran Mojsilović, Jasmina Živković, Saša Milosavljević, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Sinik dhe Duda Balje.

Munguan: Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi.

Nga pjesëmarrësit tjerë: përfaqësues nga OSBE-ja, Senad Karaahmetović; përfaqësues nga EUSR/EU Pleurat Kurti: përfaqësues nga KDI-ja, Gramos: konsultant i Sekretariatit të KKK-së, Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtpria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, koordinatorë Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu, zyrtarë e lartë ligjore.

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i Komisionit- Igor Simić.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, me raport amandamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Kryetari, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime.

- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, me raport amandamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa**

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjit nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, me raport amandamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa.

Ai kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse pajtohen, që raporti me amandamente i komisionit funksional për Buxhet dhe Finanaca, të votohen në pako. Me këtë propozim, unanimitisht u pajtuan anëtarët e komisionit.

Pas shqyrtimit të Raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, kryesuesi konstatoi se Komisioni miratoi të njëjtin me dhjetë vota Per, dhe dy Kundër të anëtarit Kujtim Shala dhe Mufera Srbica Shinik, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.*
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.*

Mbledhja përfundoi në orën 9:45.

Përgaditur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetar i Komisionit

Igor Simić